



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURAVI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.11

Prishtinë, më 7.3.2018, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në **mbledhje morën pjesë**: Igor Simiq, kryetar i komisionit, Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Duda Balje, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Xhelal Sveçla dhe Fadil Beka.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović, (OSBE), Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: koordinatorë- Natasha Prica-Tishmadhe dhe Drita Çarkaxhiu -zyrtare e lartë e fushës.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit- **Igor Simić**.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 20.02.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me amendamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, me amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, me amendamente të Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, konstatoi se anëtarët e komisionit miratuan rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20.02.2018

Kryetari, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 20.02.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthime ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Ai nënvizoi se sipas përvojave, votimi i amendamenteve nga ana e komisioneve Parlamentare bëhet në grup dhe sygjeroi që edhe komisioni jonë ta praktikojë të njëjtën.

Kryetari, në fillim hodhi në votim amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe konstatoi se komisioni i miratoi të njëjtat, pa ndryshime.

Theksoi se GP i Listës Serbe ka dhënë amendamente në këtë Projektligj dhe të njëjtat nuk janë miratuar nga ana e komisionit funksional, me këtë fakt nuk pajtohen përfaqësuesit e listës serbe, dhe për këto arsye nuk do të votojmë Projektligjin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari, hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për, dhe 4 (katër) Kundër, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligjin nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financanuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- III. Arsyetimin e këtij Raporti para Kuvendit e paraqet kryetari i komisionit, Igor Simiq.

Arsyetim

1. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 7.03.2018, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080 dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
2. Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Listës Serbe të përfaqësuar në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjese Financave Publike

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim konkret në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Jasmina Zjivković, theksoi se komisioni funksional për Mbikëqyrjese Financave Publike nuk ka miratuar amendamentet e propozuara nga GP i Listës Serbe dhe për këtë arsye nuk do të votojë Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Kryetari, gjithashtu vuri në dukje se komisioni funksional nuk ka miratuar amendamentet e propozuara të Listës Serbe, dhe ne si grup parlamentar, nuk do të votojmë raportin e komisioni funksional në Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 8 (tetë) vota Për, 4 (katër) Kundër, dhe 1 (një) Abstenim, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme

Veton Berisha, informoi komisionin se ishte konsultuar me Drejtorinë për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare dhe është këshilluar që nuk ka nevojë të bëhen ndryshime të Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës pasi që Qeverina e Kosovës në konsultim me Presidentin e Republikës dhe përfaqësuesit e komunitetit Serb, do të përcaktojnë ndryshimet e ditëve festive. Megjithatë, ai shpjegoi në detaje se se nuk është pajtuar me këtë qëndrim dhe sipas mendimit të tij zgjidhja më adekuate është të inicohet ndryshimi i Ligjit për Festat Zyrtare. Duhet theksuar, se ditët memoriale, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.

Kryetari, Kryetari tha se në mbledhjen e fundit, komisioni vendosi të fillojë procedurën e ndryshimit të Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, me propozimin e deputetit të Veton Berisha. Sipas mendimit të tij, komisioni duhet të fillojë ndryshimin e ligjit në fjalë, në mënyrë që ditët memoriale të rregulloara me dispozita ligjore.

Kujtim Shala, sa i përket çështje së ngritur, konsideron se zgjedhja më adekuate është që Komisioni të marr iniciativën për amandamentimin e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në formë unanime, nxori këtë:

Përfundim

- I. *Grupi punues të vazhdojë punën në bazë të vendimit Nr. 01- VI-2018 për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.*
- II. *Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë për koordinimin e komisionit, të hartojë Raportin e shkruar, për shqyrtim dhe miratim në Komision dhe të procedohet më tej.*

*Mbledhja përfundoi në orën 10:30.
Pregadiur nga stafi mbështetës i Komisionit*

Kryetar i komisionit,

Igor Simiq